

VENDIM
Nr.348, datë 7.6.2006

PËR INFORMATIZIMIN E REGJISTRIT TREGTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për realizimin e informatizimit të regjistrit tregtar, Instituti i Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar (INIMA) realizon:

a) në mjediset e veta, me një grup juristësh, përpunimin e dosjeve të regjistrit tregtar, që ndodhen në gjykatën e Tiranës, duke nxjerrë si produkt një ekstrakt të standardizuar, për t'u regjistruar në kompjuter;

b) programin që do të funksionojë në rrjet për regjistrimin e ekstrakteve në kompjuter, si dhe për nxjerrjen e tyre në shtyp, sa herë që të jetë e nevojshme;

c) regjistrimin në kompjuter të këtyre të dhënave, për rreth 50 mijë shoqëri tregtare të regjistruara, me një ekip operatorësh, që do të punojnë në mjediset e INIMA-s.

2. Të gjitha të dhënat do të regjistrohen në dy servera, të cilat, në përfundim të këtij projekti, të kalojnë pronë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

3. Për realizimin e këtij regjistri të punësohen, për 4 muaj, punonjës me kontratë pune të përkohshme, nga të cilët:

- juristë 40 punonjës;

- operatorë 40 punonjës.

4. Buxheti për realizimin e "Informatizimit të regjistrit tregtar", të jetë 11 054 744 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dyzet e katër) lekë dhe efektet financiare të përballohen nga fondi i Ministrisë së Financave.

5. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, që, në bashkëpunim me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të organizojnë punën për drejtimin metodologjik, kualifikimin e juristëve, për nxjerrjen e ekstraktit, si dhe për dorëzimin e dosjeve në INIMA.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për ndjekjen dhe realizimin e këtij projekti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha